



06/Shtator/2011



USAID
FROM THE AMERICAN PEOPLE

DOKUMENT PËR VEPRIM NË LIDHJE ME GJYQËSORIN E KOSOVËS

Përmirësimi i kënaqshmërisë publike me punën e gjyqësorit

PËRMBAJTJA

Hyrje.....	3
Historik dhe arsyetim.....	4
Konstatimet e Raportit.....	5
Faktorët që i kontribuojnë pakënaqsisë.....	7
Rekomandimet dhe veprimet pasuese.....	9

Hyrje

Pas publikimit të Raportit Pulsi Publik i Kosovës, synimi i së cilit është që të analizojë një fushë tematike që ndërlidhet me institucionet qeveritare dhe publike i identifikuar në bazë të analizës së të dhënave nga hulumtimi, Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGjK), si organ që administron sistemin e drejtësisë në Kosovë¹, ishte përzgjedhur si institucioni i parë për të pranuar Dokumentin për Veprim, kryesisht për shkak të faktit se kënaqshmëria e publikut me punën e gjyqësorit ishte në nivelin më të ulët². Siç tregojnë të dhënat nga hulumtimi i opinionit publik, niveli i kënaqshmërisë me punën e gjykatave të Kosovës kishte rënë për rreth 9 pikë të përqindjes që nga prilli i vitit 2010. Rënia prej rreth 12 pikë të përqindjes shënoi nivelin e kënaqshmërisë me punën e Prokurorisë, duke e ulur në vetëm 15% në krahasim me 27% sa ishte në prill të vitit 2010³.

Ky Dokument për Veprim është i kufizuar në fushëveprimin e tij, synimi i tij nuk është që të jetë dokument gjithëpërfshirës që do të mbulojë të gjitha çështjet me të cilat përballet gjyqësori tani, por synon që të analizojë çështjet që ndikojnë negativisht në perceptimin publik në lidhje me punën e përgjithshme të të gjithë akterëve në gjyqësor, dhe të jep disa rekomandime dhe mjete të cilat mund të kontribuojnë në afat të shkurtër dhe të gjatë në arritjen e kënaqshmërisë së opinionit publik me punën e gjyqësorit në përgjithësi.

¹ Që nga publikimi i Raportit Pulsi Publik, u formua Këshilli Prokurorial i Kosovës, kështu që Këshilli Gjyqësor i Kosovës nuk është më përgjegjës për administrimin e Prokurorisë.

² Raporti Pulsi Publik i Kosovës faqe 13.

³ Ibid.

Historiku dhe arsyetimi

Raporti Pulsi Publik i UNDP-së është vazhdimësi e Raportit të Paralajmërimit të Hershëm (RPH), një seri raportesh që analizoi trendët kryesor në kënaqshmërinë e opinionit të gjerë publik me punën e institucioneve publike që nga gushti i vitit 2002. Raporti siguron analiza të çmueshme të perceptimit publik përderisa Kosova konsolidonte demokracinë e saj dhe bënte progres në drejtim të përforsimit të institucioneve dhe qeverisjes së saj. Raporti zhvendosë analizën nga paralajmërimi i hershëm dhe parandalimi i konfliktit në dialog demokratik dhe monitorim të stabilitetit institucional. Përmes kësaj analize që kryet dy herë në vit dhe debateve që kanë të bëjnë me këtë analizë, synohet përmirësimi i komunikimit në mes të institucioneve publike dhe demokratike⁴.

Dokumenti për Veprim, si dokument pasues i të gjeturave nga Raporti Pulsi Publik, synon që të adresojë çështjet e nënvizuara në raport, dhe parashihet si një produkt i bashkëpunimit me institucionin e identifikuar qeveritar apo publik. Dokumenti për Veprim përmban veprimet pasuese për të adresuar çështjet specifike. Përmes diskutimit të të dhënave nga hulumtimi me zyrtarët e institucioneve të Kosovës, Dokumenti për Veprim synon zhvillimin e besimit dhe komunikimit në mes të institucioneve të Kosovës dhe opinionit të gjerë publik. Tutje, do të organizohen diskutime të mëtejshme me qëllim të rishikimit të përparimit të veprimeve të identifikuara në dokumentin për veprim nga institucioni i përzgjedhur.

Përzgjedhja e KGjK-së si institucioni i parë publik për hartimin e Dokumentit për Veprim nuk është bërë paqëllim. Nuk ishte vetëm niveli i ulët i besimit publik që ndikoi te ky vendim, por edhe vet roli i KGjK-së në ndërtimin e mjedisit të qëndrueshëm të sundimit të ligjit në Kosovë, si parakusht i shoqërisë demokratike, që shpeshherë nënçmohej dhe minimizohej, prandaj ky Dokument për Veprim do të synojë që të jep kontributin në ekspozimin publik në shkallë më të lartë të organit kryesor të administrativit të gjyqësorit.

⁴ Raporti Pulsi Publik i Kosovës faqe 9.

Konstatimet e raportit Pulsi Publik

Kur prezanton të dhënat e kënaqshmërisë publike me punën e gjyqësorit dhe prokurorisë, Raporti Pulsi Publik përcjellë vazhdimësinë e RPH-së dhe paraqet një tabelë që tregon amplitudat e kënaqshmërisë nga viti 2007 gjer tani për të tri degët kryesore të autoritetit:

Tabela 1: Kënaqshmëria me punën e institucioneve kryesore të Kosovës (në përqindje)

		Mar-07	Qer-07	Tet-07	Dhje-07	Maj-08	Korr-08	Tet-08	Pri-09	Qer-09	Shta-09	Jan-10	Pri-10	Nën-10
Kënaqshmëria me punën e pushtetit ekzekutiv	Qeveria	30.50%	35.99%	28.12%		46.85%	49.85%	55.71%	38.00%	53.13%	55.83%	36.72%	29.21%	25.06%
	Kryeministri	54.00%	66.00%	61.00%		72.00%	63.23%	63.12%	39.81%	53.84%	51.98%	41.50%	36.36%	30.65%
Kënaqshmëria me punën e pushtetit legjislativ	Kuvendi	31.00%	31.96%	36.19%	36.76%	51.36%	46.00%	49.03%	33.63%	53.18%	46.37%	33.34%	34.05%	32.10%
	Kryetari i Kuvendit	35.43%	33.23%	37.14%	35.10%	56.48%	43.55%	46.97%	32.77%	51.59%	49.45%	40.30%	36.03%	33.25%
	Presidenti	52.00%	64.00%	59.00%	61.00%	74.00%	68.09%	69.93%	45.66%	61.72%	60.75%	56.63%	54.88%	30.84%
Kënaqshmëria me punën e pushtetit gjyqësor	Gjykatat	20.00%	20.00%	18.00%	18.00%	21.00%	19.52%	19.71%	20.04%	32.65%	25.60%	14.73%	27.21%	18.50%
	Prokuroria	22.70%	19.79%	17.70%	18.27%	22.66%	22.79%	21.05%	20.46%	31.74%	25.74%	14.81%	26.85%	15.06%

Siç mund të shihet, gjyqësori është institucioni më së paku i besueshëm nga opinion i gjerë publik ku që nga viti 2007 e gjer tani ka pasur rënie në kënaqshmërinë me punën e gjykatave për 1.5% kurse kënaqshmëria me punën e prokurorisë ka rënë më dukshëm dhe tani qëndron në 7,6%. Në përgjithësi, shifrat 18.5% dhe 15,1% të kënaqshmërisë me punën e gjykatave dhe prokurorive me të vërtetë janë shqetësuese. .

Gjatë hulumtimit të kryer për nevojat e Raportit, u siguruan edhe të dhëna tjera që tregojnë trendët në perceptimin e opinionit të gjerë publik në lidhje me punën e gjyqësorit.

Në përgjithësi, 57.5% e të intervistuarve janë shumë të pakënaqur apo të pakënaqur me punën e gjykatave, kurse niveli i pakënaqësisë me prokuroritë është 44.3%. Tutje, në total 83.8% e të intervistuarve besojnë se gjyqësori i Kosovës nuk është i pavarur gjatë marrjes së vendimeve.

Sa i përket perceptimit rreth prezencës së korrupsionit në gjyqësor, 76.5% e të intervistuarve besojnë se korrupsioni është prezent në shkallë të lartë. Megjithatë, kur u pyetën se si kanë krijuar këtë mendim, vetëm 15.5% e bazojnë mendimin e tyre në përvojën personale, kurse

52.3% e të intervistuarve e bazojnë perceptimin e tyre në informatat e pranuar nëpërmjet medieve.

Tutje, 75% e të intervistuarve thanë se nuk janë përballë me ndonjë situatë ku është kërkuar ryshfet/dhuratë/favor nga ta nga ana e zyrtarit publik si kusht për të kryer shërbimin, dhe vetëm 6.6% e të intervistuarve thanë se i kanë dhënë ryshfet ndonjë zyrtari në gjyqësor.

Më sipër janë paraqitur të dhënat që na tregojnë se perceptimi publik, në veçanti në lidhje me prezencën e korrupsionit në gjyqësor, mund të konsiderohet si paksa e çrregulluar, pasi që nuk bazohet në përvojën personale, por kryesisht nga ajo që i është shërbyer opinionit publik përmes medieve dhe burimeve tjera (gjithashtu 21% e të intervistuarve bazojnë përgjigjet e tyre në atë çfarë kanë dëgjuar nga të afërmit apo miqtë e tyre), që mund të thuhet se është çështje për debat.

Gjithashtu, marrëdhënia paksa e tendosur e Agjencisë Kosovare Anti-Korrupsion (AKAK) dhe gjyqësorit gjithashtu mund të ketë ndikuar perceptimin negativ rreth autoriteteve gjyqësore i cili krijohet te opinionin publik nëpërmjet medieve. Shefi i AKAK-së ka deklaruar publikisht se agjencia përballlet me vështirësi në bashkëpunimin me prokurorinë dhe deklaroi se lëndët e dorëzuara nga AKAK nuk përcillen fare⁵. Portretizimi i tillë i autoriteteve gjyqësore nga një agjenci tjetër qeveritare se nuk dëshiron që të hetojë rastet e korrupsionit, natyrisht se i kontribuon perceptimit negativ te opinionin publik, përkundër shpjegimit të mundshëm se, sipas zyrtarëve nga prokuroria, raportet nga AKAK në të shumtën e rasteve nuk janë të kompletuara dhe nuk përmbajnë fakte mbi të cilat autoritetet gjyqësore mund të vazhdojnë punën e tyre⁶.

Sa i përket pakënaqësisë së përgjithshme me punën e gjyqësorit, që është në shkallën prej 57.5%, kjo mund të jetë ndikuar kryesisht nga pamundësia e opinionit të gjerë publik, sipas mendimit të tyre, që të realizojnë të drejtat e tyre para gjykatave, për çfarëdo arsye, të cilat do të mundohemi t'i analizojmë në seksionin e poshtëm të Dokumentit.

⁵ Gjatë debatit rreth korrupsionit në gjyqësor në programin TV “Jeta në Kosovë” shefi i AKAK deklaroi se rastet të cilat raportohen nga AKAK te prokuroria nuk përpunohen dhe se prej 21 rasteve të raportuara, prokuroria është përgjigjur vetëm në 4 prej tyre ku 2 janë hedhur poshtë dhe 2 tjera rezultuan në arrestime.

<http://kosovo.birn.eu.com/al/1/31/11491/?tpl=30>

⁶ Si më lart.

Faktorët që i kontribuojnë pakënaqësisë

“Drejtësia e vonuar është drejtësi e mohuar” me tërë kuptimin e saj⁷, është e pranishme në Kosovë, që paraqet atë çfarë me të drejtë mund të konsiderohet si problemi kryesor në mungesën e besimit publik në punën e gjyqësorit. Siç u diskutua më sipër, shifra prej 57.5% e të intervistuarve që konsiderojnë punën e gjyqësorit të Kosovës si të pakënaqshme, kryesisht i atribuohet numrit ekzistues të lëndëve të mbetura, ku njerëzit presin me vite⁸ gjersa lënda të paraqitet në seancë dëgjimore para gjykatës, dhe gjersa procedura në lidhje me lëndën të përmbillet me aktgjykim.

Përkundër përpjekjeve për lëvdatë nga institucionet vendore dhe komunitetit ndërkombëtar që punon në Kosovë, numri i lëndëve të mbetura mbetet i lartë. Sipas Planit Strategjik të KGjK-së për Gjyqësorin e Kosovës 2007-2012, KGjK-ja ka miratuar Strategjinë kombëtare për reduktimin e lëndëve të mbetura⁹. Sipas strategjisë, në tremujorin e parë të zbatimit në vitin 2011 u zgjodhën 14,295 lëndë, por megjithatë numri i lëndëve të mbetura mbetet në 119.181¹⁰. Procesi i verifikimit dhe riemërimit gjithashtu i ka kontribuar reduktimit por edhe shtimit të numrit të lëndëve të mbetura. Nëpër gjykatat ku të gjitha vendet e punës janë plotësuar, numri i lëndëve të mbetura është duke rënë në mënyrë progresive. Megjithatë numri i vendeve të lira të punës është rreth 150 që paraqet pengesë për disa gjykata dhe zyra të prokurorisë në kryerjen e punës me kapacitet të plotë. Kjo gjendje pritet që të përmirësohet dukshëm pasi që dy gjenerata të reja të gjyqtarëve dhe prokurorëve janë duke u trajnuar në Institutin Gjyqësor të Kosovës dhe pritet të përfundojnë trajnimin dhe të emërohen gjer në janar të vitit 2012¹¹. Një hap tjetër në këtë drejtim

⁷ “Drejtësia e vonuar është drejtësi e mohuar” është parim juridik që nëse mjetet ligjore janë në dispozicion për një palë që ka pësuar dëmtime, por nuk vjen me kohë, është njëjtë po që se nuk do të kishte fare mjete ligjore. Ky parim është baza për të drejtën në gjykim të shpejtë dhe të drejtat tjera që mendohet të shpejtojnë sistemin ligjor, sepse është e padrejtë për palën e dëmtuar që të pësojë dëmtimet me shpresë të vogël për zgjidhjen e problemit. Kjo frazë është bërë moto e reformuesve ligjor të cilët konsiderojnë se gjykatat apo qeveritë janë duke vepruar tepër ngadalë në zgjidhjen e çështjeve ligjore për shkak se sistemi ekzistues është tepër kompleks apo i tejngarkuar, apo sepse çështja apo pala në fjalë nuk ka favorizime politike. Shih tutje në http://en.wikipedia.org/wiki/Justice_delayed_is_justice_denied.

⁸ Organet ndërkombëtare të monitorimit në Kosovë vazhdimisht kanë raportuar rreth vonesave në procedurat gjyqësore në Kosovë. Shih për shembull raportin e OSBE-së për lëndët civile në Kosovë në <http://www.osce.org/kosovo/19401>.

⁹ Strategjia u miratua me Vendimin nr. 22/2010 të KGjK-së të datës 18 nëntor 2010.

¹⁰ Shih, <http://www.drejtësia-ks.org/?cid=2,15,171>.

¹¹ Gjenerata e tretë dhe e katërt e Programit Fillestar të Arsimit Juridik përbëhet prej rreth 90 kandidatëve.

është se KGjK-ja ka punësuar rreth 60 zyrtarë për përmbarim të ri të cilët do të trajtojnë lëndët e mbetura.

Tutje, tani janë në vazhdim e sipër disa aktivitete që synojnë t'i ndihmojnë gjyqësorit në reduktimin e lëndëve të mbetura. Ministria e Drejtësisë, me ndihmën e donatorëve¹² është në procesin e krijimit të shërbimit të noterisë. Gjithashtu me ndihmën nga UNDP-ja dhe USAID-i, Ministria e Drejtësisë ka krijuar Komisionin për Ndërmjetësim dhe Sekretarinë e saj dhe është në proces e sipër të përzgjedhjes dhe trajnimit të ndërmjetësuesve. Është paraparë që këto dy përpjekje t'i kontribuojnë dukshëm në reduktimin e lëndëve të mbetura në Kosovë, pasi që rreth 70% të lëndëve të mbetura konsiderohen se janë të natyrës jokontestimore dhe kurrë nuk do tarrinin në gjykatë nëse këto dy institucione do të ishin funksionalizuar.

Së dyti, një faktor tjetër që shpeshherë anashkalohet, por duhet të konsiderohet si shumë i rëndësishëm në krijimin e opinionit të gjerë publik, është raportimi i medieve në lidhje me gjyqësorin që ndërlidhet me pamundësinë e gjykatave që të “shesin” më me agresivitet storjet e tyre të suksesit. Siç është paraqitur në të dhënat statistikore më sipër, 52% e të intervistuarve bazojnë perceptimin e tyre në lidhje me korrupsionin në gjyqësor nga informatat e pranuar nga mediet, kurse 21% e të intervistuarve bazojnë perceptimin e tyre në atë çfarë kanë dëgjuar nga të afërmit dhe miqtë. Prandaj mund të thuhet se opinionin e gjerë publik në lidhje me korrupsionin në gjyqësor bazohet kryesisht në informatat të cilat janë “të dorës së dytë”.

Së treti, duhet të merret parasysh edhe numri i individëve që kritikojnë punën e gjyqësorit për shkak të pakënaqësisë së tyre personale apo të familjes dhe miqve të tyre me ndonjë vendim të gjykatës.

¹² Projekti financohet nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe zbatohet nga ‘Institut international des Hautes etudes Notariales’ në bashkëpunim të ngushtë dhe përkrahje nga Projekti për Përkrahje të Drejtësisë nga USAID/NCSC.

Rekomandimet dhe veprimet pasuese

Siç u tha në hyrje, fushëveprimi i këtij dokumenti për veprim analizon vetëm një numër të kufizuar çështjesh që janë të ndërlidhura me gjyqësorin dhe publikun, prandaj rekomandimet dhe veprimet pasuese për zbatim do të përqendrohen vetëm në ato çështje.

Në kuptim të reduktimit të lëndëve të mbetura, KGjK-ja duhet të vazhdojë me përpjekjet e saj në zbatimin e Strategjisë Kombëtare për reduktimin e lëndëve të mbetura, gjithashtu duke kërkuar punë më të madhe dhe duke monitoruar punën e gjyqtarëve në bazë të normave më të ashpra dhe mekanizmave monitorues që kanë të bëjnë me numrin e lëndëve të përfunduara në muaj/tremujor.

KGjK-ja gjithashtu duhet të avokojë në mënyrë më proaktive me Ministrinë e Drejtësisë që të përshpejtojë dhe të finalizojë procesin e krijimit të shërbimeve të noterisë dhe ndërmjetësimit, të cilat do të çlirojnë sistemin e gjykatave nga një numër i madh i lëndëve. Në lidhje me këtë, USAID-i dhe UNDP-ja duhet t'i ofrojnë KGjK-së asistencën e nevojshme.

Strategjia ekzistuese për Informimi Publik (SIP) e KGjK-së duhet të forcohet me qëllim që t'i përgjigjet në mënyrë më efektive publicitetit negativ që ka kapluar punën e gjykatave. Fillimisht, KGjK-ja mund të merr parasysh punësimin e Zyrtarit për Informim Publik (ZIP), të vendosur në Gjykatën Supreme të Kosovës, me synim që të punësojë nga një ZIP në çdo gjykatë të qarkut. ZIP do të jetë përgjegjës për punën e përditshme me përfaqësuesit e medieve dhe me publikun, duke siguruar informata të shpeshta në lidhje me punën e gjykatave, në veçanti duke theksuar çështjet siç janë lëndët e përfunduara, numri i rigjykimeve, dhënia e publicitetit më të madh lëndëve më serioze/të rëndësishme, të cilat mund t'i kontribuojnë pasqyrës më pozitive të gjyqësorit që portretizohet nëpër medie, e kështu duke çuar në rritjen e kënaqshmërisë dhe besimit publik në gjyqësor.

Donatorët siç janë USAID-i dhe UNDP-ja duhet të ndihmojnë KGjK-në, apo të udhëheqin përpjekjet në organizimin e trajnimeve për përfaqësuesit e medieve, që do t'i kontribuojë edukimit të tyre në lidhje me ndarjen e kompetencave brenda gjyqësorit, duke çuar në raportim më objektiv në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me gjyqësorin.

KGjK-ja duhet të bëj përpjekje që të përmirësojë komunikimin në mes të gjykatave ashtu që shtylla e gjyqësorit të ruaj kohezionin dhe pavarësinë dhe të gjitha gjykatat të jenë të njoftuara rreth ndryshimeve që do të pasojnë në organizim, që parashikohen me Ligjin për Gjykatat.

Në fund, KGjK-ja duhet të përforcojë organet e saj disiplinore dhe të publikojë rezultatet e procedurave disiplinore, me qëllim që opinioni i gjerë publik të njoftohet me punën e autoriteteve gjyqësore në drejtim të ruajtjes së standardeve më të larta profesionale në radhët e tyre.